



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 53.
Prishtinë, më 16.10.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB, Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuese i Institutit Demokratik të Kosovës Nevahir Hazeri, përfaqësues të zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 04/L-144 me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit Nr. 04/L-145, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente
6. Të ndryshme

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 11.09.2012, 25.09.2012, dhe 2.10.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 04/L-144 me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 04/L-144, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr. 04/L-144 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit Nr. 04/L-145, me raportin e komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit Nr. 04/L-145, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit Nr. 04/L-145 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi – theksoi se për realizimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, të bazuara sipas pikës: 141 dhe 143, si detyrë e Komisionit është realizimi i vizitës në terren të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në zonën e Mitrovicës, ku niveli i kontaminimit me plumb është shumë i lartë.

Në këtë drejtim, grupi punues ka organizuar më 17.10.2012, të realizohet vizita në pjesën jugore të Mitrovicës por konstatoi se në të njëjtën ditë është caktuar mbledhja e Seancës Plenare. Për tu respektuar procedurat parlamentare, kërkesa e tij është që vizita të shtyhet për javën e ardhshme.

Albert Kinolli – me theks të veçantë tha se për arsye të angazhimeve parlamentare, vizita e organizuar në terren të shtyhet për ditën e mërkurë, më 24.10.2012, ku do të vëzhgohet për së afërmi situatën e gjendjes shëndetësore të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilët jetojnë në zonën e kontaminuar me plumb, në pjesën jugore të Mitrovicës.

Propozimi i tij ishte që në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit, ftesa të përsëritet për ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministrin e Komuniteteve dhe Kthim. Ishte i mendimit, që gjatë takimit të jenë prezent edhe përfaqësuesit nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës.

Kryesuesi – e njoftoi komisionin se pas mbledhjes do të takohet me përfaqësuesit e MercyCorps, ku do të shtjellohen tema lidhur me zhvillimet dhe zhvendosjen e komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në zonën jugore të Mitrovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic